

Datë: 17.03.2021

Termet e Referencës

Thirrje për: Ekspert/e për Hartimin e Strategjisë së përbashkët për dhjetë shkolla fillore dhe të mesme të ulëta në forcimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të mekanizmave miqësorë për parandalimin dhe referimin e dhunës në shkollë

I. Hyrje

Organizata Syri i Vizionit (SiV) është regjistruar zyrtarisht si OJQ lokale në Shtator të vitit 2001, por ka filluar të funksionojë më herët që nga 1999 si Organizatë e Bazuar në Komunitet (CBO) në komunën e Pejës. Përgjatë viteve të fundit, OJQ “Syri i Vizionit” ka zhvilluar partneritete të shumta me një spektër të gjerë të organizatave lokale dhe ndërkombëtare, komunave dhe faktorëve tjerë aktivë në Kosovë dhe Ballkan si: Komisioni Evropian, Save the Children në Kosovë, Olof Palme International Centre, Solidar Suisse, Volkshilfe Solidaritet, ADA, USAID, KEC, KFOS, DRC, CARE International, OSCE, etj.

II. Informata të përgjithshme

Syri i Vizionit (SiV) në partneritet me Save the Children zyra në Kosovë (SCiK), tash e disa vite është duke punuar në programe mbi monitorimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Kosovë, që kanë për qëllim respektimin e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës, në kuadër të të cilave ka zhvilluar projekte për të fuqizuar mekanizmat e parandalimit të dhunës, ndëshkimit trupor dhe raportimit të rasteve të dhunës në shkollat e komunave Pejë, Klinë, Prishtinë, Prizren, Mitrovicë, Ferizaj, Gjilan dhe Gjakovë.

Në kuadër të programit tematik në fushën e mbrojtjes së fëmijës **“Detyrimi ynë për të Ardhmen - Mbrojtja e Fëmijës dhe Qeverisja e të Drejtave të Fëmijës”**, po punohet në parandalimin e dhunës dhe ndëshkimit trupor ndaj fëmijëve në çdo ambient, krijimin e mekanizmave apo instrumenteve miqësore dhe të besueshme ndaj fëmijëve për të raportuar rastet e dhunës në shkollë, si dhe ngritjen e vetëdijes së institucioneve dhe gjithë shoqërisë mbi Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës dhe përgjegjësive që dalin nga ky ligj.

Pjesë e rëndësishme e programit është ngritja e kapaciteteve të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta në parandalimin e dhunës ndaj nxënësve, përmes fuqizimit dhe zhvillimit të mekanizmave miqësorë për parandalimin dhe raportimin e dhunës në shkolla.

III. Objektiva

Syri i Vizionit kërkon të angazhojë një ekspert- profesionist (ekspert në fushën përkatëse) për hartimin e strategjisë së përbashkët që ka të bëjë me forcimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të mekanizmave miqësorë për parandalimin dhe referimin e dhunës në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta (*Ramiz Sadiku dhe Xhemail Kada në Pejë, Haziz Tola dhe Ibrahim Fehmiu në Prizren, Selami Hallaçi dhe Thimi Mitko në Gjiilan, Zekeria Rexha dhe Yll Morina në Gjakovë dhe Ismet Rraci dhe Motrat Qiriazi në Klinë*) dhe. Strategjia do të përcaktojë objektiva të përbashkëta bazuar në mekanizmat, nevojat, mundësitë dhe kapacitet ekzistuese që kanë shkollat për të ndërmarr veprime të përbashkëta në parandalim të dhunës dhe duke krijuar një rrjet joformal ndërmjet këtyre shkollave.

IV. Kualifikimi i nevojshëm:

- Diplomë Universitare në departmentin e Pedagogjisë apo Psikologjisë, Punë dhe/ose Mirëqenie Sociale, apo fushë të ngjashme në shkencë sociale (kualifikimi Master dhe edukimi profesional/joformal në këtë fushë është përparësi);
- Dokumentimi i përvojës së punës në hartimin e strategjive apo planeve të punës dhe raporteve të nxjerra nga hulumtimet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna;
- Njohuri për parimet e të drejtave të fëmijëve të bazuara në KDF dhe KB;
- Njohuri mbi sistemin e arsimit në Kosovë me theks të veçant mbrojtjen e fëmijëve dhe respektimin e të drejtave të tyre në shkollë;
- Shkathtësi të shkëlqyera analitike, udhëheqëse, trajnuese, dhe shkathtësi në shkrim dhe komunikim;
- Shkathtësi të mira në të shkruar dhe të folur të gjuhës shqipe dhe angleze.

V. Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Nga eksperti/ja i/e angazhuar pritet:
- Përgatitja e planit të punës, përfshirë metodologjinë, draft-agjenden për këtë angazhim dhe zhvillimi i materialeve të nevojshme për punëtorin;
- Udhëheqja e punëtorisë dy ditore me akterët përgjegjës (përfaqësuesit e shkollave, stafin nga SiV dhe SCiK) dhe hartimi i draftit të parë të strategjisë me rekomandimet dhe sugjerimet e pjesëmarrësve;
- Dorëzimi i draftit të parë të strategjisë tek SiV, jo më vonë se shtatë (7) ditë pas mbajtjes së punëtorisë për rishikim nga SiV dhe SCiK;
- **Dorëzimi i dokumentit final/Strategjisë për aprovim tek SiV jo më vonë se tre (3) ditë pune pas pranimit të komenteve;**
- Dorëzimi i raportit me shkrim tek SiV jo më vonë se pesë (5) ditë pune pasi të ketë dorëzuar dokumentin final/strategjinë të aprovuar nga SiV dhe SCiK.

VI. Angazhimi i Ekspertit/es:

Eksperti/ja do të angazhohet me anë të një kontrate për shërbim me Syri i Vizionit- nën koordinimin e Menaxherit të Financave dhe Administratës. Në këtë kontratë do të përcaktohen në mënyrë specifike pikat të cilat nuk janë të përfshira në këtë dokument. Angazhimi do të bëhet në baza ditore, ku do të përfshihen aktivitetet e mëposhtme:

Detyrat	Kohëzgjatja
Familjarizimi me raporte dhe përgatitja e metodologjisë së punës për punëtorin (Metodologjia, agjenda dhe materialet tjera të nevojshme)	1/2 ditë
Mbajtja e punëtorisë për hartimin e strategjisë me përfaqësuesit e dhjetë shkollave (<i>përfaqësues nga Menaxhmenti, komisioni për rutinë e ankesave dhe këshilli drejtues i shkollës</i>) për përcaktimin e objektivave dhe aktivitetëve duke u bazuar në nevojat dhe propozimet që dalin nga vetë pjesëmarrësit si vijon: - <ul style="list-style-type: none"> - Qëllimi; - Objektivat; - Aktivitetet; - Rezultatet; - Indikatorët 	2 ditë
Hartimi dhe Finalizimi i Strategjisë	1 ditë
Përgatitja dhe dorëzimi i raportit narrativ	1/2 ditë
Gjithsej:	5 ditë

VII. Kushtet e Pagesës:

Pagesa e ekspertit/es do të bëhet sipas faturës përkatëse për kryerjen e shërbimeve, që do të leshohet nga ai/ajo, ose do të përgatitet nga SiV e do nënshkruhet nga Eksperti/ja. Pagesa do të realizohet përmes transaksionit bankar në valutën Euro. Pagesa do të bëhet pas përfundimit me sukses të punëtorisë dhe dorëzimit të dokumentit final/Strategjinë dhe raportit narrativ të aprovuar nga SiV.

Në bazë të ligjit të Kosovës, Syri i Vizionit është po ashtu i obliguar që të paguajë tatimin (taksa dhe Pension) prej 10% të shumës bruto. Shpenzimet e ushqimit gjatë punëtorisë do t'i mbulojë organizatori.

VIII. Dokumentet dhe procedura për aplikim:

- Metodologjinë e punës për këtë angazhim, përfshirë planifikimin e mbajtjes së punëtorisë dhe hartimin e strategjisë;
- **Nje letër interesi që paraqet arsyet që ai/ajo është i/e përshtatshëm dhe ka njohuri dhe eksperiencë në fusha të ngjashme;**
- Diplomë Universitare që deshmon kualifikimin e tij/saj;
- Curriculum Vitae (CV);



Aplikacionet duhet të dorëzohen në formë elektronike në e-mail adresën: office@syrivizionit.org me subjektin: Aplikacioni për Hartimin e Strategjisë së përbashkët për shkolla. Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është data 05 prill 2021 ora 17:00.